

SYLLABUS I LËNDËS: DIZAJN ILUSTRIMI

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FAKULTETI I ARTEVE Programi i studimit - Artet Vizuale (BA) Dizajni Grafik & Multimedia
Titulli i lëndës:	Dizajn Ilustrimi
Niveli:	Bachelor-BA
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti -IV- (Semestri: VII - VIII)
Numri i orëve në javë:	3+1
Vlera në kredi – ECTS:	10
Koha / lokacioni:	E enjte, ora 11.30-14.00, Klasa a1/19 Fakulteti i Arteve
Mësimdhënësi i lëndës:	Muhamet Ahmeti - Metis
Detajet kontaktuese:	<ul style="list-style-type: none"> - E-mail: muhamet.ahmeti@uni-pr.edu - metis.muhametahmeti@gmail.com - Web: www.metis-art.com - Mob: + 383 44 192919 - Adresa: Rexhep Krasniqi, nr.71, Prishtinë
Përshkrimi i lëndës	Lënda Dizajn Ilustrimi zhvillohet duke bërë studime intensive dhe duke përfshirë teknikat dhe parimet e kurseve të mëparshme me theks të veçantë në koncepte dhe përsoshmëri artistike. Ky proces ka të bëjë me studimin e detajizuar të fushës së ilustrimit dhe aspekteve të biznesit. Këto aspekte përfshijnë fushat e ndryshme të menagjimit komercial dhe artistik duke përgatitur vepra arti të sukseshme për riprodhim dhe për vetëpromovim. Diskutimet relevante rreth biznesit dhe inkorporimit të ilustrimit në medime të ndryshme do të jenë pjesë përbërëse të këtij kursi.
Qëllimi i lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> - Aftësimi i studentëve për pjesëmarrje të pavarur në festivale të ndryshme rajonale e botërore. - Përvetësimi i njohurive kreative për dizajnimin e ilustracioneve të të gjitha grupmoshave. - Aftësimi i studentëve për veprimtari të pavarur kreative në zgjidhjen e detyrave të parashtuara nga fusha e ilustrimit për fëmijë. - Ngritja dhe zhvillimi individual i studentëve në rrugët kërkimore të detyrave sipas porosisë dhe temave të kërkuara.
Rezultatet e pritura të nxënies:	- Studentët në fund të semestrit të tetë do të përvetsojnë njohuri dhe përvojë të duhur kreative

	<p>në fushën e ilustrimit tematik dhe të botimeve tjera ilustrative për grupmosha të ndryshme.</p> <p>- Ata në këtë fazë studiuëse do të shpalosin ide e çasje konkurruese me individualitet origjinal e kreativ në botime dhe ekspozita të ndryshme.</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (korrespondenca me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	30 (15+15)	60
Ushtrime teorike/laboratorike	2	30 (15+15)	60
Punë praktike	3	4 (2+2)	12
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	12 (6+6)	12
Ushtrime në teren	3	6 (3+3)	18
Kollokfiume,seminare	-	-	-
Detyra të shtëpisë	2	16 (8+8)	32
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	20 (10+10)	20
Përgaditja përfundimtare për provim	3	6 (3+3)	18
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	6 (3+3)	6
Projektet,prezentimet ,etj	3	4 (2+2)	12
Totali	21	134	250
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Mësimdhënia bazohet në metoda të përshtatura praktike dhe teorike, si: ligjërata, diskutime, ushtrime, punë praktike duke përdorë mjete konkretizuese në laborator, detyra dhe projekte tematike.</p> <p>Krijimtaria dhe hulumtimi i studentëve në zgjidhjen e detyrave përcillet deri në realizimin final të tyre.</p> <p>Mësimi dhe forma e kërkimit dizajnuet për realizimin e detyrave praktike të procesit riprodhues realizohet me përdorimin e disa teknikave të njohura figurative, (vizatim, temper, tush, pastel, teknikë të kombinuara) dhe me programe kompjuterike, (Adobe Photoshop, Adobe InDesign, CorelDRAW, etj.).</p> <p>Konkretizimi i mësimit bëhet edhe me vizita në shtypshkronjë, studio dizajni, galeri, etj.</p> <p>Gjatë procesit mësimor parashtrihen detyra kërkuese për të zhvilluar dhe debatuar kreativitetin individual. Aty kërkohen rrugë të ndryshme kreative gjatë hulumtimit vetanak dhe diskutohen arritjet praktike dhe mësimet alternative të studentëve.</p>		
Metodat e vlerësimit:	Sistemi i vlerësimit sipas detyrimeve semestrale:		
	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja aktive dhe vijimi i rregullt <u>25 pikë</u> - Provimi i pjesshëm në detyra <u>25 pikë</u> 		

	- <u>Provimi përfundimtar</u> <u>50</u> <u>pikë</u> <u>Totali</u> <u>100</u> <u>Pikë</u>
	Sistemi i vlerësimit: <ul style="list-style-type: none"> • 100% - 92% e totalit të notës10 (dhjetë) • 91% - 82% e totalit të notës 9 (nëntë) • 81% - 72% e totalit të notes 8 (tetë) • 71% - 62% e totalit të notës7 (shtatë) • 61% - 52% e totalit të notes6 (gjashtë) • 51% - 42% e totalit të notës.....5 (pesë)

Literatura	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - https://doabooks.org/ - https://rudolphmuteswa.com/ - Dinamika e komunikimit masiv, Joseph R. Dominick; - Graphic designer's color handbook, Rick Sutherland, Barb Karg; - Historia e Artit, E.H. Gombrich.
Literatura shitesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Tipografia, Emil Ruder - Lichtenstein, Janis Hendrickson

Plani i dizejnuar i mësimit: Semestri 7

Javët	Ligjeratat
Java e parë:	- Përvojat kreative të ilustrimit dizajnuar nëpër botë ; (Shembuj nga festivalet botërore të ilustrimit, stripit dhe karikaturës, etj).
Java e dytë:	- Detyra /13/ Ilustrimi tematik: "Kosova-shteti im" Mënyra kërkimore dhe realizimi i skicave;
Java e tretë:	- Pasqyrimi i ndjenjës artistike në ilustrime; - Shembuj nga literatura ilustrative;
Java e katërt:	- Zgjedhja e skicave për realizim përfundimtar;
Java e pestë:	- Kompozicioni dhe elemente tjera figurative në ilustrime;
Java e gjashtë:	- Ngjyrosja dhe hijezimi i ilustrimit;
Java e shtatë:	- Prezentimi i detyrës /13/ me përshkrim realizues;
Java e tetë:	- Orë zgjedhore, (vizitë në galeri, bibliotekë, shtypshkronjë);
Java e nëntë:	- Detyra /14/ Ilustracioni për fëmijë. (fabulë, tekst autorial, përrallë etj);
Java e dhjetë:	- Krijime ilustrative për ilustracion sipas përshkrimit;
Java e njëmbëdhjetë:	- Skica dhe ide kreative për ilustrim sipas tekstit përshkrues;
Java e dymbëdhjetë:	- Krijimet ilustrative për libër dhe mundësitë avansuese; - Diskutim dhe kritikë vlerësuese;
Java e trembëdhjetë:	- Dizajnimi grafik i ilustracionit;
Java e katërbëdhjetë:	- Prezentimi i detyrës /14/ me përshkrim realizues;
Java e pesëmbëdhjetë:	- Debat i hapur lidhur me rezultatet e arritura; - Përfundimi i semestrit.

Plani i dizejnuar i mësimit: Semestri 8

Javët	Ligjeratat
Java e parë:	<ul style="list-style-type: none"> - Shtëpitë botuese / produksionet grafike; - Koncepti ekskluziv dizajnuar i projekteve botuese.
Java e dytë:	- Detyra /15/ Projekti im editorial. (Botim letrar, monografi, katalog publicitar, etj);
Java e tretë:	- Koncepti ideor dhe përzgjedhja e temës;

	(Skica ideore për mënyrën e dizajnit duke përcaktuar formatin, stilin piktoral (ilustrativ), lidhjen grafike, etj);
Java e katërt:	- Zgjedhja dhe përcaktimi i skicave realizuese;
Java e pestë:	- Krijimi i imazheve piktorale (ilustrative) për projektin botues;
Java e gjashtë:	- Prezentimi dhe mbrojtja e konceptit me përshkrim;
Java e shtatë:	- Vijimi i realizimit të projektit me ndërhyrje korigjuese;
Java e tetë:	- Njohuri dhe punë praktike në shtypshkronjë;
Java e nëntë:	- Diskutim i hapur vlerësues për punimet e realizuara;
Java e dhjetë:	- Specifikat dhe përshtatja grafike e piktorale; - Përzgjedhja e realizimeve të suksesshme ;
Java e njëmbëdhjetë:	- Dizajni grafik i botimit në Indesign CS 5);
Java e dymbëdhjetë:	- Korigjim me variacione të zgjedhura kreative; - Përfundimi i ilustracioneve me hijezim dhe finesa tjera grafike;
Java e trembëdhjetë:	- Fazat realizuese të projektit botues;
Java e katërmëdhjetë:	- Prezentimi i detyrës /15/ me përshkrim realizues;
Java e pesëmbëdhjetë:	- Debat i hapur lidhur me rezultatet e arritura; - Përfundimi i studimeve bachelor.